



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



Nr. 29 prot

Dt. 29/06/2022

VENDIM

Nr. 22 , datë 22.06.2022

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS KËRKESË PËR LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJIK”, SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjik të “HEC Pobreg”, subjektit “Energy Plus” sh.p.k., me vendndodhje, lumi “Luma”, rrethi Kukës, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor lumi “Luma”

HEC Pobreg

Vepra e marrjes, koordinatat në KRGJSH

- X= 542508
- Y= 4657786
- Z= 399 m.m.n.d

Godina e Centralit

Pika e shkarkimit, koordinatat në KRGJSH

- X= 538050
- Y= 4659423
- Z= 297 m.m.n.d
- $Q_{mes}=11 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{llog}=14 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{eko}=0.46 \text{ m}^3/\text{s}$
- Fuqia max e instaluar $N= 12000 \text{ kW}$

3. Periudha e vlefshmërisë: Në përputhje me afatet e koncensionit.
4. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

